

Falja e namazit – për fillestarë

﴿ صفة الصلاة – للمبتدئين ﴾

[Shqip – Albanian – ألباني]

Abdullah Ebu Muhamed Abdurr-Rahmani

Redaktoi: Një grup thirrësish

2010 - 1431

islamhouse.com

﴿ صفة الصلاة – للمبتدئين ﴾

« باللغة الألبانية »

عبد الله أبو محمد عبد الرحمن

مراجعة: مجموعة من الدعاة

2010 - 1431

islamhouse.com

Pasqyra e lutjeve që thuhën gjatë faljes së farzeve

Rekati	Namazi	Sabahu	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia
1		Subhaneke Eudhubilahi Fatiha (Kewther)	Subhaneke Eudhubilahi Fatiha (Kewther)	Subhaneke Eudhubilahi Fatiha (Kewther)	Subhaneke Eudhubilahi Fatiha (Kewther)	Subhaneke Eudhubilahi Fatiha (Kewther)
2		Fatiha (Ihlas) Et-Tehijatu (SELAMI)	Fatiha (Ihlas) Et-Tehijatu	Fatiha (Ihlas) Et-Tehijatu	Fatiha (Ihlas) Et-Tehijatu	Fatiha (Ihlas) Et-Tehijatu
3			Fatiha	Fatiha	Fatiha Et-Tehijatu (SELAMI)	Fatiha
4			Fatiha Et-Tehijatu (SELAMI)	Fatiha Et-Tehijatu (SELAMI)		Fatiha Et-Tehijatu (SELAMI)

Ezani dhe Ikameti

Ezani / **Ikameti** Ezani thuhet para fillimit të namazit, ndërsa ikameti para fillimit të farzeve

		Përkthimi
4	4	ALL-LLAHU EKBER
2	2	ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LALL-LLAH
2	2	ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDER-RESULLULL-LLAH
2	2	HAJJE 'ALES-SALAH
2	2	HAJJE 'ALEL-FELAH
2	-	ES-SALATU HAJRUN MINEN-NEWM (vetëm në sabah)
-	2	KAD KAMETIS-SALAH
2	2	ALL-LLAHU EKBER
1	1	LA ILAHE IL-LALL-LLAH

Disa nga thëniet e Muhammedit a.s. rreth faljes

-Çka mendoni, sikur të ishte një lumë para derës së ndonjërit prej jush, në të cilin do të lahej për çdo ditë nga pesë herë, a do të mbetej në të ndytësi? Thanë: -Nuk do të mbetej kurrfarë ndytësie. Lajmëtar i a.s. tha: -Ky është shembulli i pesë kohëve të namazit. All-llahu me faljen e namazeve i shlyen mëkatet. (579)

-Pesë namazet prej njërit deri te tjetri, namazi i xhumasë prej njërit deri te tjetri dhe prej një ramazani gjer në ramazinin tjetër, janë pastrues të mëkateve në mes tyre, nëse ruheni prej mëkateve të mëdha. (96)

Abdull-llahu ibn Mes'udi r.a. ka thënë: -E kam pyetur të Dërguarin a.s.: Cila punë është më e dashur te All-llahu i Madhëruar? Tha: Namazi në kohën e vet. -I thashë: Pastaj cila? Tha: -Bamirësia ndaj prindërve. -I thashë: Pastaj cila? Tha: -Xhahadi në rrugë të All-llahut. (205)

Një njeri ka thënë: -O i Dërguar i All-llahut, më trego për një punë që do të më shpie në Xhennet dhe do të më largojë nga Xhehennemi! I Dërguari a.s. tha: -Ta adhurosh All-llahun dhe të mos i shoqërosh asgjë, ta falësh namazin, ta ndash zekatin dhe t'i mbash lidhjet farefisnore. (214)

-A dëshironi t'ju tregoj se me çka All-llahu i shlyen mëkatet e juaja dhe me çka i lartëson gradat tuaja? Të pranishmit i thanë: -Po, o i Dërguar i All-llahut! I Dërguari a.s. u tha: -Marrja e abdestit edhe atëherë kur është

vëshirë, shkuarja e shpeshtë në xhami dhe pritja e namazit pas namazit. Kjo është fortifikatë, kjo është fortifikatë. (572)

-Namazi i njeriut në xhemat është më i vlefshëm se namazi i tij në shtëpinë e tij apo diku tjetër për njëzet e disa shkallë. Kush merr abdest në formën më të mirë, pastaj shkon në xhami me të vetmin qëllim që ta falë namazin në xhemat, duke mos i interesuar asgjë tjetër, për çdo hap të tij i shtohet nga një gradë dhe i shlyhet nga një mëkat derisa të hyjë në xhami, e kur të hyjë në xhami, atëherë në namaz është aq sa i ka marrë kohën namazi. Secilin prej jush e bekojnë engjëjt, derisa të gjendet në vendin ku është falur namazi, ata thonë: "O Zot, mëshiroje! O Zot, fale! O Zot, pranoja pendimin". Engjëjt veprojnë kështu përderisa njeriu të mos fillojë t'u pengojë të tjerëve, apo ta prishtë abdestin në xhami. (8)

-Kush e fal namazin e jacistë me xhemat, është sikurse ai që gjysmën e natës e kaloi në namaz. Ndërsa ai, që e fal namazin e sabahut me xhemat, është sikurse ai i cili është falur tërë natën. (591)

Aisheja r.a. ka thënë: I Dërguari a.s. çohet natën (dhe falej) aq gjatë saqë këmbët iu patën ënjtur, andaj unë i thashë: Përse po vepron kështu o i Dërguar i All-llahut, kur t'i ka falur ty All-llahu mëkatet e mëparshme dhe të pastajmet? Ai tha: A të mos jem rob falënderues? (70)

-Kush merr abdest bukur e mirë, pastaj shkon në namaz të xhumasë, atje hesht dhe dëgjon (hutben), i falen mëkatet e bëra ndërmjet dy xhumave dhe tri ditë më tepër. Kush argëtohet në xhami me rërë (dhe gjëra të tjera), e ka zhvlerësuar dobinë e xhumasë. (94)

-Zotimi i cili na ndan neve dhe ata (pabesimtarët) është namazi, andaj ai që e lë atë ka bërë mosbesim. (97)

-Për dyfytërshtit nuk ka namaz më të rëndë se namazi i sabahut dhe i jacistë, e sikur ta dinin se çka ka në ta, do të vinin në xhemat në këto dy namaze edhe rrëshqanas. (93)

-Kush e fal namazin e sabahut, është nën mbrojtjen e All-llahut, andaj mos i kundërvihet askush kësaj me diçka, sepse kush i kundërvihet kësaj, All-llahu do ta arrijë atë, dhe pastaj do ta gjuajë me fytyrë në zjarr të Xhehennemit. (245)

-Kush e lë namazin e ikindisë, i humb e tërë puna e tij. (583)

-Urdhëroni fëmijët tuaj për namaz kur t'i kenë shtatë vjet, kurse detyroni me forcë (rrihni) kur t'i bëjnë dhjetë vjet dhe ndajini në shtretër (të veçantë). (199)

Marrë nga përmbledhja e haditheve "Rijadus-Salihin" (versioni i xhepit)



Falja e namazit për fillestarë

me përkthim të lutjeve

Krijuesi ynë, All-llahu thotë:

14. Ka shpëtuar ai që është pastruar,
15. Që ka përmendur emrin e Zotit të vet dhe që është falur,
16. Por ju i jepni përparësi jetës së kësaj bote,
17. Ndërsa jeta tjetër është më e mirë dhe e përherëshme!"

(ajete nga sureja A'LA)

1. Kanë shpëtuar besimtarët,
2. Të cilët gjatë namazit janë të përlulur...
9. Dhe të cilët e ruajnë namazin e tyre
10. Të tillët janë trashigimtarët
11. Trashiguesit e Firdeusit, ku do të banojnë përgjithmonë.

I dërguari i Fundit, Muhammedi a.s. ka thënë:

"Gjëja e parë për të cilën do të japë llogari robi (i All-llahut) në Ditën e Ringjalljes është namazi. Nëse i ka kryer namazet sipas rregullave, atëherë do të jetë i shpëtuar dhe ka korrur sukses. Nëse namazet do të jenë të paplota (të mangëta), do të përjashtohet nga mirësia dhe do të jetë i humbur. Nëse do të ketë diçka të paplotësuar nga farzet (obligimet e

domosdoshme), All-llahu i Lartmadhëruar do t'u thotë (melekëve):

-Shihni se a ka kryer robi Im ndonjë namaz vullnetar, me të cilin do t'ia kisha plotësuar farzin.

Pastaj edhe veprat tjera do të gjykojnë në të njëjtën mënyrë."

Gjithashtu ka thënë:

"...Shtylla e fesë është namazi..."

Dhe:

"...Islam është:

1. Të dëshmosh se s'ka hyjni tjetër pos All-llahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij;
2. Ta kryesh faljen;
3. Ta japish zekatin;
4. Ta agjërosh muajin Ramadan dhe
5. Ta kryesh haxhin nëse ke mundësi."

Kushtet për vlefshmërinë e namazit

-Nuk bën të jesh xhunub - i (e) papastuar nga përjetimi seksual ose (vlen vetëm për femrat) e papastuar nga periudha mujore. Që të pastrohesh, duhet ta lash tërë trupin.

-Nuk bën ta kesh kryer nevojën (qoftë të madhen ose të voglën) dhe të mos e kesh larë vendin me ujë. Nëse je stërpikur (ndotur) me nevojë, duhet ta lash teshën ose të veshish tjetër.

-Namazi nuk vlen pa marrë **abdest**. **Abdesti** mirret kështu: Duke patur për qëllim marrjen e abdestit, thua **Bismil-lah** dhe i lan nga tre herë: duart, gojën, hundën, fytyrën, krahët deri në bërryl, i fërkon me dorë të lagët flokët dhe veshët, dhe i lan këmbët deri te nyjet.

-Me një abdest mund të falen disa namaze, ndërsa abdestin e prishin kryerja e nevojës, lëshuarja e gazit, gjumi, etj.

-Gjatë faljes mashkulli duhet ta ketë të mbuluar trupin së paku prej kërthizës deri te gjunjtë, ndërsa femra duhet ta mbulojë tërë trupin, pos fytyrës dhe duarve.

-Para se ta fillosh faljen, kthehesh kah Kabja dhe vendosesh para ndonjë **sutre** (sutre mund të jetë muri, druri, shpina e njeriut, guri pak më i madh ose ndonjë objekt tjetër jo i gjallë).

-Gjatë faljes ndalohej të folurit, të qeshurit, të shikuarit lartë ose anash dhe e gjithë kjo ka për qëllim koncentrimin sa më të madh të falësit, sepse ai vendos kontakt me Krijuesin e tij, i Cili meriton lavd-falënderim dhe frikërespekt të denjë.

-Para se të fillosh faljen, duhet të kesh për qëllim faljen e kohës së caktuar. Nëse të ndodh që ta falish ikindinë, ndërsa për qëllim ke patur faljen e drekës, duhet ta përsërisish namazin.

-Namazin e falë në kohën e vetë.

Kohërat e faljes

1. **Sabahu** (*Fexhr*) falet në agim, prej kur fillon dallimi mes errësirës së natës dhe dritës së zbehtë të mëngjesit, dhe vazhdon deri para lindjes së diellit.
2. **Dreka** (*Dhuhr*) falet pasi që dielli lëviz prej zenitit, deri në atë pozitë kur hija e objektit fiton gjatësinë e objektit.
3. **Ikindia** (*'Asr*) falet pas mbarimit të drekës dhe vazhdon deri para perëndimit të diellit.
4. **Akshami** (*Magrib*) fillon pas perëndimit të diellit deri në errësimin e horizontit.
5. **Jacia** (*'Isha*) falet pasi që horizonti errësohet plotësisht, deri para agimit.

Lavd-falënderimi i takon All-llahut, qoftë paqja mbi të Dërguarin e Tij dhe mbi të gjithë besimtarët

Përgatiti: Abdull-llahu ebu Muhammed Abdur-rahmani
Shkup, nëntor 2003 (Shewwal 1424)

Tabela e rekateve

Namazi përbëhet nga pjesët e quajtura **rekate**.

Në vazhdim po tregojmë nga sa rekate kanë namazet:

namazi	rekate	Sunnet	Farz	Sunnet	Vitri
Sabahu		2	2		
Dreka		4	4	2	
Ikindia		(4)	4		
Akshami			3	2	
Jacia		(4)	4	2	3

Çdo namaz, qoftë farz ose sunnet falet për hir të Zotit dhe askujt tjetër.

Namazet farz janë obligim nga Zoti për çdo musliman të vetëdijshëm, dhe për mosfaljen e tyre pa shkak pason dënimi në këtë jetë dhe pas vdekjes.

Namazet sunnet është mirë që të falen ngase ato i ka falur edhe Muhammedi a.s. gjithmonë kur ka patur mundësi. Në tabelë janë cekur 12 rekate sunnet që Muhammedi a.s. zakonisht i ka falur dhe e ka lavdëruar faljen e tyre duke thënë: "Çdo musliman që vullnetarisht falë 12 rekate gjatë ditës për hir të All-llahut pos farzeve, All-llahu do t'ia ndërtojë një shtëpi në Xhennet." Ndërsa në një rast ai ka thënë: "Katër rekate para dreke, dy pas dreke, dy pas akshamit, dy pas jacisë dhe dy para sabahut". Transmetohet se ai ka falur namaz edhe pas ikindisë dhe para akshamit. Ai ka thënë: "Ndërmjet çdo ezani dhe ikametit ka namaz" dhe këtë e ka përsëritur 3 herë, pastaj ka thënë: "Për atë që dëshiron."

Namazi i vitrit nuk është mirë të lihet pa falur, edhe pse nuk është farz. Muhammedi a.s. atë nuk e ka lënë pa falur.

Përveç këtyre namazeve, Muhammedi a.s. ka falur edhe namaze të tjera vullnetare, si për shembull është çuar natën dhe ka falur namaz nate, ose ka falur namaz pas lindjes së diellit, ose kur është zënë dielli, ndërsa ndonjëherë ka falur namaz para se të ndërmarrë ndonjë vendim të rëndësishëm për ndonjë çështje të kësaj bote. Këto janë namaze vullnetare dhe kryerja e tyre edhe pse nuk është e domosdoshme, çmohet shumë.

FALJA E SABAHUT

REKATI I PARË

1 I ngren duart dhe thua:

ALL-LLAHU EKBER



All-llahu është më i Madhi

Përkthimet



2 E vëndon dorën e djathtë mbi të majtën dhe thua:

SUBHANEKE ALL-LLAHUMME WE BI HAMDIKE WE TEBAREKESMUKE WE TE'ALA XHEDDUKE WE LA ILAHE GAJRUKE

E'UDHU BIL-LAHI MINESH-SHEJTANIR-RAXHIM



Dëlirësia të takon Ty, Zoti im, dhe falënderimi, emri Yt është i bekuar, e lartësuar është Madhështia Yte, s'ka hyjni pos Teje

Mbështetem në All-llahun nga djalli i mallkuar

- FATIHA**
1. BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM
 2. EL HAMDULIL-LAHI RABBIL 'ALEMIN
 3. ER-RAHMANIR-RAHIM
 4. MALIKI JEWMID-DIN
 5. IJJAKE NA'BUDU WE IJJAKE NESTA'IN
 6. IHDINAS-SIRATAL MUSTEKIM
 7. SIRATAL-LEDHINE EN 'AMTE 'ALEJHIM, GAJRIL MAGDUBI 'ALEJHIM WE LED-DAL-LIN (AMIN)

1. Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
2. Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botërave
3. Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
4. Sunduesit të ditës së Gjykimit
5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë
6. Udhëzoni në rrugën e drejtë,
7. në rrugën e atyre ndaj të cilëve ke bekimin, e jo në të atyre që je i hidhëruar, dhe që kanë humbur! (Amin)

Kjo është sureja (kaptina e Kur'anit) **Fatiha**, e cila duhet doemos të thuhet gjatë faljes së namazit

KEWTHER

1. BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM
2. FE SAL-LI LI RABBIKE WEN HAR
3. INNE SHANIEKE HUWEL EBTER

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Vërtet Ne të dhamë ty të Mirën (e pashtershme)
2. Pra falu për Zotin tënd dhe sakrifiko
3. Vërtet urrejtësi yt është farësosur.

Kjo është sureja **Kewther**, në vend të së cilës mund të thuhet ndonjë sure tjetër e Kur'anit

3 Duke thënë: **ALL-LLAHU EKBER** kërrusesh dhe i ven duart mbi gjunj. Në këtë pozitë (e cila quhet *ruku*) thua tre herë:

SUBHANE RABBIJEL 'ADHIM



I Dëlirë është Zoti im Madhështor

4 Duke thënë:

SEMI' ALL-LLAHU LIMEN HAMIDEH

drejtolesh dhe thua:

RABBENA LEKEL HAMD



All-llahu dëgjon atë që e falënderon

Zoti ynë, Ty të takon falënderimi

5 Thua **ALL-LLAHU EKBER** dhe përulesh me ballë në tokë. Në këtë pozitë (e cila quhet *sexhde*) thua tre herë:

SUBHANE RABBIJEL A'LA



I Dëlirë është Zoti im i Lartë

6 Thua **ALL-LLAHU EKBER** dhe ulesh. Në këtë pozitë thua:

RABBI GFIRLIJ, GFIRLIJ



Zoti im, falmë, falmë

7 Thua **ALL-LLAHU EKBER** dhe e bën edhe një *sexhde* duke thënë përsëri tre herë

SUBHANE RABBIJEL A'LA



I Dëlirë është Zoti im i Lartë

8 Thua **ALL-LLAHU EKBER** dhe çohesh në këmbë për *rekatin* e dytë.

REKATI I DYTË

9 Përsëri e vëndon dorën e djathtë mbi të majtën dhe e thua suren **FATIHA** (shih veprimin 2), ndërsa pas saj suren **IHLAS**:

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM

1. KUL HU WALL-LLAHU EHAD
2. ALL-LLAHUS-SAMED
3. LEM JELID WE LEM JULED
4. WE LEM JEKUN L-LEHU KUFUWEN EHAD



Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Thuaj: Ai, All-llahu është Një
2. All-llahu është Strehuesi
3. S'ka lindur kë, as nuk është i lindur
4. Dhe Atij askush nuk i përmgjan

Edhe në vend të kësaj sureje mund të zgjidhet ndonjë sure tjetër

Pas kësaj, si në rekatin e parë kërrusesh, drejtolesh dhe i bën dy *sexhde* (d.m.th. i përsërit veprimet 3,4,5,6 dhe 7).



10 Pas *sexhdes* së dytë thua **ALL-LLAHU EKBER**, ulesh dhe thua:

ET-TEHIJJATU LIL-LAHI WES-SALAWATU WET-TAJJIBATU ES-SELAMU 'ALEJKE EJJUHEN-NEBIJU WE RAHMETULL-LLAHI WE BEREKATUHU ES-SELAMU 'ALEJNA WE 'ALA 'IBADIL-LAHIS-SALIHIN ESH HEDU EN LA ILAHE IL-LALL-LLAH WE ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDEN 'ABDUHU WE RESULUHU

Përsëritjet i takojnë All-llahut, si dhe lutjet dhe fjalët e mira Paqja qoftë mbi ty, o Lajmëtar, si dhe mëshira e All-llahut dhe begatitë e Tij Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të All-llahut Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër pos All-llahut dhe se Muhammedi është rob i Tij dhe i dërguari i Tij

11 PËRFUNDIMI I NAMAZIT:

I ulur thua:

ALL-LLAHUMME SAL-LI 'ALA MUHAMMEDIN WE 'ALA ALI MUHAMMED KEMA SAL-LEJTE 'ALA IBRAHIME WE 'ALA ALI IBRAHIM INNEKE HAMIDUN MEXHID

ALL-LLAHUMME BARIK 'ALA MUHAMMEDIN WE 'ALA ALI MUHAMMED KEMA BAREKTE 'ALA IBRAHIME WE 'ALA ALI IBRAHIM INNEKE HAMIDUN MEXHID

O All-llahu im, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e bekoje Ibrahimin dhe familjen e tij, Ti je i Falënderuar dhe i Lartësuar.

O All-llahu im, begatoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e begatove Ibrahimin dhe familjen e tij, Ti je i Falënderuar dhe i Lartësuar.

LUTJA KUR'ANORE

ALL-LLAHUMME RABBENA ATINA FID-DUNJA HASENETEN WE FIL-AHIRETI HASENETEN WE KINA 'ADHABEN-NAR. RABBENA GFIRLI WE LI WALIDEJJE WE LIL-MU'MININE JEWME JEKUMUL HISAB

O All-llahu im, Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe na ruaj nga dënimi me zjarr. Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët ditën kur do ta japim llogarinë.

Në vend të kësaj lutjeje mund të thuhet ndonjë tjetër nga Lutjet e Lajmëtarit a.s.

12 Namazi përfundon me dhënien e **SELAMIT**:

e kthen kokën së pari në të djathtë dhe thua:

ES-SELAMU 'ALEJKUM WE RAHMETULL-LLAH

dhe në të majtë:

ES-SELAMU 'ALEJKUM WE RAHMETULL-LLAH



Paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi ju



Paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi ju

FALJA E DREKËS, IKINDISË DHE JACISË

Këto namaze kanë nga katër rekate. Duke patur për qëllim (nijet) faljen e namazit përkatës, i fal dy rekate e para njëloj si në namazin e sabahut deri në veprimin 10, ndërsa pas lutjes **ET TEHIJJATU** duke thënë **ALL-LLAHU EKBER** çohesh në këmbë për rekatin e tretë.

REKATI I TRETË

13 I lidh duart dhe e thua vetëm suren **FATIHA**. Pastaj e kryen rukun, drejtolesh, i bën dy *sexhde* dhe duke thënë **ALL-LLAHU EKBER** çohesh në këmbë (si në veprimet 3,4,5,6,7 dhe 8).

REKATI I KATËRT

14 Edhe në këtë rekat e thua vetëm suren **FATIHA**, e kryen rukun, drejtolesh, i bën dy *sexhde* (veprimet 3,4,5,6,7 dhe 8) dhe në fund ulesh dhe e përfundon namazin me lutjet **ET TEHIJJATU**, **SALAWAT** dhe **LUTJEN KUR'ANORE** dhe në fund jep **SELAMIN** (veprimet 10,11,12).

FALJA E AKSHAMIT

Akshami ka tre rekate. Duke patur për qëllim faljen e tij i fal tre rekate e para njëloj si tre rekate e drekës, ndërsa pas kësaj nuk çohesh për rekatin e katërt, por ulesh duke thënë **ALL-LLAHU EKBER** dhe e përfundon namazin duke i thënë lutjet: **ET TEHIJJATU**, **SALAWAT**, **LUTJEN KUR'ANORE** dhe jep **SELAMIN** (si në veprimet 10, 11 dhe 12).

FALJA E SUNETEVE

Falja e suneteve dy rekateshe bëhet si falja e sabahut, ndërsa falja e suneteve katër rekateshe bëhet si falja e drekës, me atë që duhet patur për qëllim (nijet) faljen e tyre.